



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

1	Data 15.02.19	Vendi Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-4577	7.

## RAPORTI I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

K a ç a n i k, Shkurt 2019

Hartoi: Zyra e Kryetarit të Komunës  
Shqyrton: Kuvendi i Komunës

## Vështrim hyrës

Në Raportin Vjetor të punës për periudhën 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018, kam nderin dhe privilegjin që të prezantoj angazhimet, sfidat dhe të arriturat e vitit 2018.

Të gjitha aktivitetet e Komunës së Kaçanikut janë realizuar në harmoni të plotë me Statutin Komunal dhe zbatimin e përgjegjësi si Kryetar i Komunës, duke administruar pushtetin lokal në harmoni me kompetencat e Kryetarit. Duke qenë përfaqësues i Komunës dhe duke vepruar në emër të saj, jam munduar të shtrijë bashkëpunimin e Komunës me qytetarët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme, rininë etj.

Një bashkëpunim të sinqertë e kam zhvilluar edhe me partitë politike e veçanërisht me opozitën duke krijuar një klimë bashkëpunuese, gjithnjë në interes të gjithë qytetarëve. Takimet dhe debatet me qytetarët kanë qenë të shpeshta, ndërsa janë trajtuar tema të ndryshme me theks të veçantë Buxheti i Komunës për vitin 2019, ndërkohë që janë mbajtur katër dëgjime buxhetore dhe dy debate të rregullta me qytetarë .

Edhe gjatë këtij viti jemi përballur me shumë sfida e vështirësi, por falë punës dhe angazhimit tonë të përbashkët, kemi arritur të finalizojmë shumë punë e projekte që kanë për qëllim mirëqenien qytetare. Llogaridhënia dhe transparencja qytetare, janë objektivat parësorë të cilat kanë përcjellur qeverisjen tonë lokale. Edhe gjatë vitit 2018, kemi përmbushur 100 % nivelin e transparencës komunale, duke hyrë në mesin e pesë komunave me performancën më të mirë, e duke u shpërblyer me grantin e performancës. Mirëqenia qytetare ishte prioritet i yni edhe gjatë këtij viti. Shumë projekte kapitale komunale u realizuan gjatë këtij viti, pa lënë anash asnjë fshat apo lagje të qytetit. Investime u realizuan në Infrastrukturë rrugore, ndriçim publik, trotuare, instalim dhe rregullim të rrjeteve të kanalizimit e ujësjellësit, mirëmbajtje të rrugëve dhe ambientit, investime në arsim, kulturë rini e sport, ndërsa kujdes të veçantë i kemi kushtuar sigurisë qytetare përmes ndriçimit publik në lagje e fshatra si dhe tek varrezat e dëshmorëve- aty ku pushojnë pishtarët e lirisë. Gjatë kësaj periudhe, nga lista e investimeve kapitale me buxhetin e komunës janë realizuar gjithsej 19 projekte rrugësh të asfaltuar dhe ndërtuar me kubëza , ku gjatësia e rrugëve të ndërtuara arrin 11,010.46m. Edhe këtë vit investuam edhe në ndërtimin e tri urave, investim që njëkohësisht simbolizon lidhjen e njerëzve me njëri tjetrin. Poashtu përmes bashkëpunimit me institucionet qendrore, përmes ministrive të ndryshme kemi realizuar dhjetëra projekte në rregullim dhe asfaltim të rrugëve.

Projektet në arsim kanë vazhduar edhe këtë vit në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, ndërsa jemi orientuar veçanërisht në pajisjen e kabineteve me mjete të nevojshme pune, si parakusht për ngritje të cilësisë në arsim. Edhe këtë vit ka vazhduar ndarja e bursave për studentët e dalluar, duke u lehtësuar kështu barrën financiare të studimeve . Në sektorin e kulturës, Rinisë dhe Sportit edhe këtë vit nuk kanë munguar projektet dhe aktivitetet e ndryshme. Objekte dhe renovime të reja shëndetësore, kishte edhe gjatë këtij viti, të mbështetur gjithmonë përmes motos “Pacienti në qendër të vëmendjes”. Mirëqenia e kategorive sociale ishte në vëmendjen tonë, ku edhe këtë vit kemi vazhduar traditën e ndihmesës me ndihma momentale. Ndërsa vëmendje të veçantë i kemi kushtuar edhe personave me nevoja të veçanta, ku në vazhdimësi kemi përkrahur aktivitetin e organizatave që punojnë për mirëqenien e tyre, duke i mbështetur edhe me mjete financiare. Përkrahja e bujqve ishte në agjendën tonë të investimeve, duke pasur parasysh që vendi ynë përmbush kriteret kryesore për zhvillim të kësaj veprimtarie. Fermerët janë përkrahur me pajisje të nevojshme për bujqësi, ndërsa 405 bujq kanë përfituar në formë të ndryshme të mbështetjes nga Komuna e Kaçanikut. Investimet e përkushtimi

institucional nuk ka munguar edhe në administratë komunale e zhvillim ekonomik. Edhe këtë vit kemi punuar nën frymën e bashkëpunimit me institucionet qendrore, ndërsa bashkëpunimin tonë kemi zgjeruar edhe me ministrinë e tjera, të cilat kanë realizuar shumë projekte në kuadër të zhvillimit ekonomik. Bashkëpunimin kemi vazhduar me organizata Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që kanë synim krijimin e kushteve sa më të mira për qytetarët e Kaçanikut.

Prioritetet kryesore për Kaçanikun vazhdojnë të jenë:

- Ushtrimi i përgjegjësisë dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e Komunës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloret e punës;
- Mbikëqyrja e administrimit financiar të komunës dhe zbatimi i planeve investuese të komunës, përkatësisht investimet substanciale në infrastrukturë fizike duke përfshirë rrugët, ujin e pijshëm dhe kanalizimet;
- Transparenca dhe llogaridhënia;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies së qytetarëve;
- Krijimi i kushteve të volitshme për investime të drejtpërdrejta, shtimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik;
- Rregullimi i infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore;
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe ngritja e cilësisë në arsim;
- Procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje;
- Trajtimi i ujërave të zeza;
- Hartimi i hartave zonale;
- Ushtrimi me përgjegjësi i kompetencave në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës e administratë dhe zbatimin e akteve të Kuvendit të Komunës;
- Bashkëpunimi ndërkomunal dhe me nivelin qendror, Asociacionin e Komunave të Kosovës Organizatat vendore e ndërkombëtare etj.

Shërbimet janë ofruar përmes drejtorive dhe zyrave si në vijim:

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike dhe
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

Të dhënat në vijim në formë përmbledhëse tregojnë aktivitetet dhe arritjet kryesore gjatë vitit 2018. Më shumë hollësi janë dhënë në Shtojcën e bashkëngjitur në këtë raport, në të cilën jepen informata lidhur me performancën e secilës drejtori.

## Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

### Qendra për shërbime me qytetar

Objektivat themelore për vitin 2018 kanë qenë respektimi i orarit të punës dhe kërkesave të palëve, informimi i drejtë dhe i saktë i qytetarëve lidhur me kërkesat e tyre si dhe adresimi me kohë i të gjitha kërkesave që iu drejtohen Administratës dhe Kuvendit Komunal.

Në këtë kontekst, është arritur që të përmirësohen vazhdimisht shërbimet tona ndaj qytetarëve duke ulur pritjen pranë sporteve si dhe orientimin e palëve në mënyrën e duhur. Sfidë dhe obligim i vazhdueshëm për ne mbetet rritja e llogaridhënies dhe transparencës ndaj qytetarëve si dhe modernizimi i administratës duke digjitalizuar vazhdimisht shërbimet tona.

Gjatë periudhës njëvjeçare kemi arritur që konform këtyre objektivave që përmendëm më lartë, t'i pranojmë dhe procedojmë 41124 lëndë (Tab. 1.), prej këtyre vetëm 351 janë ende në proces të cilat presin zgjidhje konform ligjeve të aplikuara.

Përshkrimi	Pranuar	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Përfunduar	Totali
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	46	2	3,456	16	19,991	23,518
Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës	24	13	863	235	0	1,157
Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	21	1	881	109	0	1,024
Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit	13	20	6,499	3	0	6,548
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	7	10	159	21	0	209
Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	19	7	403	40	0	470
Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	36	255	6,177	49	0	6,542
Shërbimi i Kryetarit	56	43	1,106	432	0	1,656
	222	351	19,594	905	19,991	41,124

Tab 1. Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes prej 01/01/2018 - 30/06/2018.

Numri i kërkesave (lëndëve) në raport me zgjidhjen e tyre nëse e shndërrojmë në përqindje kap shifrën 99.02%, që në fakt ky sektor ka bërë përmirësim të dukshëm në raport me vitin 2017 (98.8%).

Kësaj ngritje të efikasitetit i kanë paraprirë caktimi i objektivave të duhura si dhe koordinimi i mirë ndërmjet punëtorëve në QKSHQ me qëllimin kryesor që pjesa procedurale mos të mbetet pengesë e qytetarëve në arritjen e synimeve dhe të drejtave të tyre që u mundësohen me ligj.

## Zyra komunale e gjendjes civile

Ne kuadër të drejtorisë së administratës së përgjithshme funksionon edhe sektori i ofiqarisë konkretisht Zyra Komunale e Gjendjes Civile. Ky sektor, vlerësohet të jetë njeri ndër më të rëndësishmit në organogramin komunal. Gjendja civile ndër tjerash, është faktori kryesor që shërben si urë lidhëse në frymën e bashkëpunimit të ngushtë me ministritë përkatëse, siç janë: MPB, MAP, MAPL si dhe departamenteve që operojnë në këto ministri.

Gjatë kësaj periudhe, kjo zyrë ka vazhduar dhe po vazhdon të përballet me kërkesa nga më të ndryshmet të cilat janë mjaft të ndjeshme për nga natyra e tyre. Megjithatë, ne kemi arritur që të menaxhojmë me këto kërkesa dhe ti procedojmë për më tutje atëherë kur rregullat kanë kërkuar ashtu.

Numri i certifikatave të lëshuara nga Zyra Komunale e Gjendjes Civile kapin shifrën 35,295. Ndërkohë, janë marrë gjithsej 159 vendime (ndryshime, korigjime RTHL, RTHM, regjistrime të mëvonshme, refuzime të kërkesave etj.).

Përshkrimi	Copë
Ekstrakte të Lindjes	18394
Certifikata të Lindjes	5237
Certifikata e Martesës	3779
Certifikata e Vdekjes	1094
Certifikata e Gjendjes Martesore	898
Deklarata Familjare	3306
Certifikata e Vëndbanimit	1302
Certifikata e Shtetësisë	401
Vërtetime të Arkivit	729
Dëshmi Vdekje	56

*Tab 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2018-31/12/2018*

Përveç certifikatave, ky sektor ka vazhduar edhe me shërbime tjera ndaj qytetarëve të cilat përfshijnë regjistrimet e lindjeve, kurorëzimet, regjistrimet e vdekjes etj. Faktikisht për ne mbetet mjaft shqetësuese fakti që janë rritur ndjeshëm kërkesat për tërheqje të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Në këtë periudhë janë evidentuar gjithsej 69 lëndë për tërheqjen e shtetësisë. Ky fakt shqetësues vjen si rrjedhojë e kërkesave të bashkatdhetarëve të cilët jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit e që janë të obliguar nga shtetet ku jetojnë, duhet të nisin procedurat për tërheqjen e shtetësisë së Kosovës. Trajtimi më serioz i kësaj çështje duhet nisur nga të gjitha komunat e Kosovës dhe t'u adresohen ministrisë vartëse në mënyrë që kjo çështje me interes nacional të trajtohet me seriozitet dhe të parandalohet ky trend gjithnjë e në rritje.

Gjithashtu gjatë vitit që po raportojmë, ky sektor ka hasur në vështirësi sa i përket furnizimit me certifikata të gjendjes civile nga MPB-ja, për shkak të procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit. Megjithatë, me përkushtimin tonë kemi arritur që këto mungesa assesi mos të vërehen nga qytetaret duke huazuar nga komunat tjera.

## **Arkivi**

Arkivi i komunës është pjesë përbërëse e DAP, dhe në kontekstin e ruajtjes së lëndëve dhe gjetjes së tyre luan rolin kryesor. Faktikisht ne përballemi shumë shpesh me palët të cilat i adresojnë kërkesat e tyre për arkivin komunal. Ne periudhën njëvjeçare kemi gjetur mjaft shumë lëndë të cilat janë kërkuar nga palët por dhe nga drejtoritë apo institucionet tjera publike.

Ne si drejtori kemi vlerësuar se me rëndësinë që ka arkivi, duhet të trajtohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Kur themi këtë potencojmë se arkivi tani gjendet në bodrumin e objektit dhe ky bodrum nuk i plotëson aq shumë kushtet infrastrukture dhe me rritjen graduale të vëllimit të lëndëve, sistemimi i tyre gjithnjë e më shumë po bëhet më i vështirë. Hapësira vlerësohet të jetë e vogël dhe nga kjo kemi filluar ta shfrytëzojmë edhe korridorin.

Në fund te vitit 2018, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të hapësirës dhe krijimit të kushteve të mira për punë, kemi arritur që të investojmë në këtë pjesë me furnizimin e raftave për lëndë si dhe krijimin e ambientit të duhur për ruajtjen e lëndëve.

Mbetet obligim i yni që të planifikojmë zgjidhje afatgjate për arkivin, duke e sistemuar në objekt të ri ose investime të vazhdueshme në vendin ku gjendet tani me qëllim të përmirësimit të kushteve konform ligjit.

Përshkrimi	
Arkivimi elektronik i lëndëve	34500 lëndë
Asgjësimi i dokumentacionit pa afat të ruajtjes	70 kuti
Asgjësimi i materialeve nga DAK	77 regjistrator
Asgjësimi i materialeve nga DEFZH	28 regjistrator
Asgjësimi i materialeve tjera	50 kuti
Kërkesa interne	172 kërkesa
Kërkesa nga palët	143 kërkesa
Kërkesa për vërtetim dokumenti	66 kërkesa

Tab 3. Realizimi i lendeve nga arkivi komunal.

### Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Në kuadër të DAP, funksionon edhe njësia komunale për të drejtat e njeriut. Gjatë vitit 2018, aktivitetet kryesore të kësaj njësie ishin si në vijim:

Takime dhe tryeza të rrumbullakëta me Shoqërinë Civile, OJQ-të, për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe barazisë gjinore në veçanti (2 takime).

Organizimi i një tryeze për të drejtat trashëgimore dhe regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve në bashkëpunim me organizatën “Gratë për Gratë” dhe Shoqërinë Civile si dhe zbatimi i Udhëzimit Administrativ cili mundëson lehtësira administrative pa pagesë në emër të dy bashkëshortëve.

Takime me HANDIKOS dhe personat me aftësi të kufizuara, përfaqësues nga institucionet komunale, qendrore, OJQ-ve(2 takime) dhe mbajtja e një ligjëratë me temën “Njihu me të drejtat tua” ku pjesëmarrës ishin 45 persona me aftësi të kufizuara.

Formimi i grupit të grave deputete në komunën tonë dhe mbajtja e dy takimeve ku është organizuar zgjedhja e kryesueses dhe zëvendës kryesueses së GGD.

Shënimi i ditës së 8 marsit, ditës së gruas, ku në bashkëpunim me GGD ju bëmë vizitë të gjitha institucioneve që veprojnë në komunën tonë, ku kishim rastin përsëafërimi të bisedonim për sfidat dhe problemet e grave të cilat punojnë nëpër institucionet tona.

Organizimi dhe mbajtja e ligjëratave për parandalimin e dukurive negative (drogave dhe alkoolit) në komunën tonë ku përfitues nga kjo ligjëratë ishin 73 nxënës në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.

Organizimi i një punëtorie me grupin e grave deputet të Kosovës (GGDK) dhe grupin e grave deputete të komunës (GGD) me ç'rast ne ishim nikoqir i katër komunave të regjionit – Ferizajt, Shtimes, Vitisë dhe Hanit të Elezit. Temë diskutimi ishte hartimi i një plani strategjik të veprimit si dhe planit të punës .

Një punëtori e organizuar ATRC me temën “ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizimi, shkaqet dhe parandalimi”.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave dhe statistikave në baza gjinore i punëtorëve të cilët punojnë nëpër institucione në komunën tonë.

Dy trajnime të organizuara nga agjencioni për barazi gjinore rreth krijimit të një mekanizmi kundër dhunës në familje me të gjithë akterët të cilët veprojnë.

Fushata vetëdijësuese me temën “Trafikimi me qenie njerëzore” ku janë mbajtur 10 ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme, pjesëmarrës ishin 225 nxënës.

10 ditë aktivitete për shënimin e ditës ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas “Dita e Kordeles së Bardhë” - të cilat u manifestuan me dy debate një tryezë e rumbullakët dhe 18 ligjërata.

Ligjëratë për shënimin e ditës së “Kordeles së Bardhë” me temën - “Infrastruktura ligjore në Kosovë për çështjen e barazisë gjinore dhe zbatimin e saj” ku përfitues ishin 370 nxënës të klasave të IX, X, XI, XII.

### **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

1-Këkesa për kushte ndërtimi 38

1.1 Kushte ndërtimore të miratuara 25

1.2 Kushte ndërtimore të refuzuara 13

2-Kërkesa për leje ndërtimi

2.1 Të miratuara 25

Nga Lejet e Ndërtimit, të cilat janë lëshuar: 2 i takojnë kategorisë së dytë

Gjithashtu projektet të cilat janë përfunduar, që kanë qenë pjesë e DUKMM-së:

- Projekti kryesor i hapësirës së varrezave të dëshmorëve
- Projekti kryesor i urës mbi lumin Lepenc në fshatin Kovacec
- Projekti kryesor i kanalizimit në fshatin Semajë
- Projekti kryesor i Stadiumit të Qytetit
- Projekti kryesor për aneksin e Shkollës së Mesme Profesionale
- Projekti kryesor – ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Shtrazë, zona turistike

Vlen të theksohet se si drejtori jemi ballafaquar me ndërrimet e destinimit për parcela të ndryshme, meqenëse PZHK-ja është në proces të hartimit.

### Spektori i Kadastrit

Gjatë vitit paraprak pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar dhe janë regjistruar 5626 lëndë, ku nga ky numër janë zgjedhur të gjitha kërkesat e pranuar nga ana e palëve fizike apo juridike. Ky sektor ka vazhduar me përpikëri të bëjë implementimin e ligjit mbi themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së paluajtshme Nr. 2002/5 dhe plotësimin të tij Nr.2003/13, si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Nga lëndët sa u përket Certifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj dhe lëndët e tjera nga RDPP, të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor që nënkupton se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal. Ky sektor nga 01.01.2018 deri 31.12.2018 ka realizuar të hyra bugjetore afërsisht në shumë prej: 53.205,00 € .

- Fleta Poseduese, Kopje Planit, Koordinata, etj	21.277,00 €
- RDPP (sipas tabelës së poshtë paraqitur)	31.928.00 €

---

TOTALI: **53.205,00 €**

Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasinë e kërkesave për secilën kategori ndaras:

= Dokumentet e lëshuara 4954 lëndë:

• Fleta poseduese	2637 lëndë
• Kopje të planit	497 lëndë
• Certifikata të gjendjes së pasurisë	1057 lëndë
• Koordinata gjeodezike	599 lëndë
• Identifikime	00 lëndë
• Të ndryshme (Pronësia, AKM, KFOR, K.K Kaçanik etj.)	48 lëndë
<b>TOTALI:</b>	<b>4838 lëndë</b>

= Regjistri i RDPP-së 788 lëndë:

<i>Ndarjet e parcelave</i>	<b>147</b>
<i>Bashkimi i parcelave</i>	<b>4</b>
<i>Regjistrim i ndërtesave</i>	<b>2</b>
<i>Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave</i>	<b>4</b>
<i>Regjistrimi i hipotekave</i>	<b>32</b>
<i>Çregjistrimi i hipotekave</i>	<b>20</b>
<i>Regjistrim i shitblerjeve</i>	<b>204</b>
<i>Regjistrimi i trashëgimive</i>	<b>106</b>
<i>Regjistrim i faljeve të pronës së paluajtshme</i>	<b>229</b>
<i>Regjistrimi i ndërrimit të pronave të paluajtshme</i>	<b>7</b>
<i>Regjistrim i përkujdesjes së përhershme</i>	<b>1</b>
<i>Çregjistrimi i barrës tatimore</i>	<b>1</b>
<i>Regjistrimi i ngarkesave tjera</i>	<b>4</b>
<i>Regjistrimi i qirambajtjeve (mbi tre vite)</i>	<b>7</b>
<i>Regjistrimi korigjimeve në regjistër (Exofficio)</i>	<b>17</b>
<i>Regjistrimi i shërbimeve tjera</i>	<b>3</b>
<b>TOTALI:</b>	<b>788</b>

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

Gjithashtu gjatë viti paraprak kemi implementuar edhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Ku përmes këtij udhëzimi bashkëshortët të cilët kanë shpreh vullnet që të regjistrojnë pronën e paluajtshme si pasuri të përbashkët kanë qenë të liruar nga pagesa e taksave pranë zyrave kadastrale komunale. Ky udhëzim ka filluar te implementohet nga Marsi i vitit 2016 deri më Mars të vitit 2017, dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës ky afat është zgjatur edhe për dy vite më Prill te vitit 2019.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eliminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siç janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, komisione për pranimin e punëtorëve etj. Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi profesional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siç janë: Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Ministria e Infrastrukturës etj, ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Komunale.

Sektori për çështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë dhe atë nga lëmia e uzurpimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike,

Shpronësimit, Mbajtjes së evidencës së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të marrëdhënieve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme.

Ky sektor ka udhëhequr procedurat e shpronësimeve të cilat janë zhvilluar gjatë viti 2018 në nivelin komunal, si dhe ka udhëhequr dokumentacionet e nevojshme të cilat janë dorëzuar për kompensim tek niveli qendror rreth pronave të shpronësuara lidhur me ekzekutimin e autostradës "Arbër Xhaferi" në territorin e komunës sonë.

Gjatë vitit 2018 sektori i kadastrit ka qenë i angazhuar në disa takime me shoqata te ndryshme si: Partners Kosova; OJQ Polis dhe OJQ W4W (Women for Women) rreth diskutimeve dhe promovimit të të drejtave të femrave në "Fuqizimi i grave përmes rritjes së vetëdijësisë për të drejtat në pronë dhe trashëgimi", ku prezenca, kontributi dhe diskutimet e ofruara dhe të zhvilluara nga sektori i kadastrit janë vlerësuar lartë si nga penalistët gjithashtu edhe nga OJQ-ët prezente gjatë takimeve.

## **DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës janar – Dhjetor 2018 ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të ngritet cilësia dhe efikasiteti në shërbimet primare shëndetësore , shërbimet sociale dhe shërbimet e inspektimit sanitar .

Ky raport përfshinë pjesën kryesore të aktiviteteve që janë realizuar gjatë këtij viti. Gjatë vitit 2018 në kuadër të D.SH.M.S -e janë ndihmuar 98 familje ku janë përfshirë pakot ushqimore dhe me mjete financiare.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur bashkëpunim të ngushtë KFOR-in Polak dhe nga Bektel Enka ku janë ndihmuar 21 familje me pako ushqimore si dhe 63 familje janë ndihmuar nga shoqata "Jetimët e Ballkanit"

Në bashkëpunim me ekipin e Zyrës Ndërlidhëse Monitoruese të KFOR-it Polak, në kuadër të aktiviteteve bamirësisë, ka dhuruare lodra për familje skamnore.

Gjatë këtij viti janë lëshuar vendime dhe vërtetime të ndryshme që i përkasin kësaj drejtorie. Është përfunduar QMF-ja në fshatin Kaçanik të Vjetër ku edhe është mobiluar në vlerë 81.453€, është ndërtuar në dy faza është investim nga buxheti komunal.

Punimet në ndërtesën e banimit social kanë vazhduar, por ende nuk kanë përfunduar përshkak të disa problemeve buxhetore, e që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka mundur ti përfundoj me kompaninë e kontraktuar.

Është bërë renovimi i disa QMF-ve dhe AMF-ve në teren .

Gjithashtu gjatë këtij viti është blerë edhe një autoambulancë për QKMF ku vlera e saj është 40.710€.

Është blerë inventar i ri për QKMF-në në Kaçanik, dhe QMF-në në Kaçanik i Vjetër, kurse inventari i blerë në vitin 2016 është shpërndare nëpër QMF-të dhe AMF-të në teren. Gjithashtu

kemi furnizuar një pjesë të QKMF-ës me kompjuter dhe stafi i QKMF-së është furnizuar me veshmbathje.

Në këtë vit është bërë përzgjedhja e një kompanie për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike në QKMF.

## SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2018 është bërë riorganizimi i brendshëm i QKMF-së , ku është ngrit cilësia e shërbimeve shëndetësore primare dhe është bërë implementimi i mjekësisë familjare në QKMF, QMF-e dhe AMF-të ekzistuese.

Transportimi i rregullt i pacienteve ne Hemodializë në Ferizaj, me dy ndërrime.

Mbajtja e rregullte e edukimit te vazhdueshëm profesional për infermier , trajnimi i personelit në mjekësinë familjare dhe ligjërata të rregullta në procesin e Zhvillimit të Vazhdueshëm profesional ( ZHVP).

Mbajtja e rregullt e trajnimeve të mjekëve në procesin permanentë të ZHVP-së .

Përcjellja e punës dhe sigurimi i funksionimit normal nëpër punktet dhe ambulancat e fshatrave.

Sigurimi i shërbimeve shëndetësore 24 orë në QKMF në Kaçanik.

Furnizimi me barna gjatë vitit 2018 nga lista esenciale deri në muajin Nëntor 2018 ka qenë më i dobët, kurse pas muajit nëntor gjendja ka filluar të përmirësohet dukshëm.

Është bërë plani i furnizimit me aparaturë, tash shpenzimet në muaj janë 90 €.

Ardhja e Pulmologut për çdo të Enjte ,lidhja e kontratës me pediatri që të kryej shërbimet e EHO Kardigrafisë tek fëmijët një herë në javë, bën që shërbimet shëndetësor për staf dhe qytetar të jen me të mira.

Është bërë lansimi i programit të vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0 deri ne 3 vjet ku nga Ministria e Shëndetësisë dhe UNICEFI QKMF-ja në Kaçanik është nderuar me mirënjohje për suksesin e zbatimit të këtij programi.

Gjate këtij viti janë mbajtur ligjërata të ndryshme nëpër shkolla nga ana e ekipeve tona mjekësore.

Në këtë vit kemi pranuar edhe donacione nga qytetar të ndryshëm për nevojat e pacientëve tanë.

Kemi pranuar donacion nga Esheref Lika nga Turqia ku për nevojat e pacienteve të sëmure nga diabeti ai ka sjell 30 lapsa të insulines Novorapid.

Nga bashkatdhetar i ynë Shukri Malsiu që punon dhe vepron në Zvicër ka sjellur 28 aparate të dëgjimit dhe këto aparate ju janë shpërndarë pacienteve që kanë pasur vështirësi në dëgjim dhe këtë e kanë dëshmuar me raportin specialistik nga specialisti i ORL-së.

Kemi pranuar donacion nga Bajram Reka i cili për nevojat e QKMF-se ka sjell dy kolica të cilat do të shërbenin për personat me nevoja të veçanta.

Po ashtu gjatë këtij viti komuna ka intervenuar në blerjen e barnave dhe materialit shpenzues mjekësor pasi që nuk kemi pasur furnizim të mjaftueshëm nga lista esenciale nga Ministria e Shëndetësisë.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes QKMF-së ka bërë mbulimin me staf mjekësor të QMF-ve dhe AMF-ve .

Gjatë këtij viti kemi pranuar shtat mjekë të përgjithshëm .

Është bërë rinovimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në AMF-ët dhe QMF-ët ku ka pasur defekte.

Gjatë vitit kemi pasur vizita monitoruese nga ministria e shëndetësisë , ku nga dy vizitat monitoruese nga Inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Inspektorati sanitar raportet e tyre janë shumë pozitive.

Kemi bërë raportimin e rregullt të sëmundjeve ngjitëse në IKSHP ( Institutin Kombëtarë të Shëndetit Publik) rajoni i Ferizajt. Si dhe raportet e rregullta ne IKSHP në Prishtinë për ecurinë e vaksinimit .

Numri i pacientëve për këtë vit ishte i ngjashëm me vitet e kaluara. Kontaktet me donatorë ishin prezent edhe gjatë këtij viti.

Me dt. 14.11.2018 është shënuar në Komunën e Kaçanikut dita ndërkombëtare e diabetit.

Kemi pasur vizita monitoruese nga Ministria e Shëndetësisë.

Është aktivizuar rrjeti i internetit në objekt të ri me fiber optik dhe ky sistem është me efikas si dhe shërbimet janë më të shpejta dhe kemi arrit të zvogëlojmë shpenzimet për internet dhe telefon nga 127 € .

### **SHËRBIMI SOCIAL**

Gjatë këtij viti Shërbimi profesional i Qendrës për punë sociale në Kaçanik është angazhuar në realizimin e programit të punës duke punuar në të gjitha format që kanë të bëjnë me Mbrojtjen Sociale. Gjatë kësaj kohe një vjeçare kemi zbatuar tërë legjislacionin në fuqi, që ka të bëjë me Shërbimin Social.

Fëmijët pa kujdesin prindor

a) Fëmijët pa dy prindër

b) Fëmijët e braktisur

c) Prindërit e fëmijëve që nuk i kryen detyrat prindore

Fëmijët e braktisur gjatë vitit 2018 nuk kemi pasur .

Prindërit e fëmijëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindore

Fëmijët e familjeve në konflikt

Keqtrajtimi i fëmijëve dhe lënia pas dore

Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të çrregulluar

Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar edhe me prindërit të cilët nuk kanë pasur kujdes ndaj fëmijëve të tyre .

Zyrtarët e Shërbimit Social janë marrë me përkujdesjen dhe përcjelljen e rastit , fëmijët janë vizituar dhe është biseduar me prindërit e tyre.

Në këtë periudë kohore jemi ballafaquar edhe me problemin e fëmijëve të familjeve me çrregullime bashkëshortore ku ky numër i fëmijëve arrin në 10. Ndërsa në trajtim të QPS-së nga zyrtarët e Shërbimit Social, këtyre fëmijëve iu është caktuar besueshmëria e njërit prind, i cili ka aftësi për tu kujdesur për rritjen dhe zhvillim normal .

**Fëmijët dhe rinia me sjellje të çrregulluar**

Prej 116 delikuentëve, 32 kanë kryer vepra penale, ndërsa 84 kanë kryer vepra kundërvajtëse. Struktura gjinore e tyre është 2 femra ndërsa të tjerët janë meshkuj.

Nga ky numër i delikuentëve kemi 25 përsëritës të veprave.

Masat e shqiptuara ndaj këtyre delikuentëve kemi : 84 delikuent kanë masën edukative

Kujdesi i shtuar prindor, 10 delikuent kanë masën –

Kujdesin e shtuar të Organit të Kujdestarisë dhe 4 delikuent

Puna me interes publik Të tjerat janë në procese të gjykatave. Në rastet e delikuentëve Zyrtarët e Shërbimit Social kanë marr pjesë gjatë intervistimit nga ana SHPK-së Kaçanik në 55 raste në kohë të ndryshme.

### **Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme ( FAKP )**

Në këtë kategori të fëmijëve me të meta, kemi evidentuar dhe i kemi udhëzuar që të gjejnë shërbim adekuat në institucionet përkatëse ,njëkohësisht i kemi udhëzuar lidhur me mundësinë e edukimit dhe arsimimit në shkolla speciale.

47 fëmijë iu është njohur nga komisioni mjekësor e drejta për ndihmë materiale për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në bazë të Ligjit 022/09, ku prej tyre janë 16 femra dhe 31 meshkuj. Në vitin 2018 kemi pasur 13 aplikime për komisionin mjekësor ku prej tyre iu është njohur e drejta vetëm 6 fëmijëve. 22 fëmijë nga ne kanë kaluar në pensionin invalidor tetrapelgjik dhe parapelgjik të cilët nuk janë në kompetencat tona por të fondin pensional.

Në QPS është evidentuar edhe kjo kategori e njerëzve ku një pjesë e tyre janë përfshirë në skemën e SNS, një pjesë iu është ofruar shërbim social, ndërsa një pjesë ka mbetur pa u përfshirë në ndihmë sociale për shkak të kriterëve të SNS .

QPS në Kaçanik këtë kategori vazhdimisht e ka këshilluar, orientuar që të vizitojnë qendrën mentale në Ferizaj ku një numër i tyre janë klientë të rregullt të kësaj qendre. Me aplikimin e ligjit për personat me aftësi të kufizuara kemi një rënie të tyre

### **Të rriturit me gjendje konfliktuozë**

Në këtë periudhë një vjeçare i kemi pasur 8 raste (çifte bashkëshortore) në kontest shkurorëzimi. QPS insiston që prindërit pas shkurorëzimit të gëzojnë të drejtën e kontaktit me fëmijët e tyre , sipas marrëveshjes paraprakisht të caktuar në mes QPS-së dhe bashkëshortëve.

Kemi pasur 3 kontaktime të fëmijëve me prindërit që janë në procedurë ligjore, prej këtyre kontakteve kemi pasur 6 fëmijë.

### **Të rriturit me sjellje asocial**

Për këtë kategori sidomos për narkomanët nuk kemi raste të paraqitjes pranë QPS-së Trafikimi i qenieve njerëzore.

Gjatë këtij viti, Shërbimi social nuk ka asnjë rast të trafikimit as të miturave por as të rriturve që është identifikuar nga Shërbimi Social.

Adoptimi ( Birësimi )

Në vitin 2018 kemi vetëm një kërkesë për adoptim , por nga vitet e më hershme kemi 8 kërkesa për adoptim, prej tyre e kanë përcaktuar edhe gjininë e fëmijës. 4 kanë kërkuar femra dhe 4 meshkuj.

Strehimi familjar tek të afërmit (Fëmijët pa dy prind)

Kemi 11 fëmijë pa dy prind ë cilët me Ligjin e Familjes me nr. 2004/32 marrin nga 100 € në muaj deri në moshën 18 vjeç.

Këta fëmijë të gjithë kanë Kujdestar Ligjor.

Shërbime tjera administrative

Gjatë vitit 2018 QPS-ja gjegjësisht Organi I Kujdestarisë ka lëshuar 82 vërtetime për zotësi të veprimt dhe 64 vërtetime për lirimin nga shtetësia e Kosovës e cila ka të bëjë që nuk ka obligime financiare ndaj familjes dhe personave të tjerë. 10 raste të pranimit të atësisë dhe amësisë.

### **Strehimi rezidencial**

Gjatë kësaj periudhe raportuese Shërbimi Social nuk ka asnjë rast të ri të strehimit rezidencial. Përherë për punën dhe angazhimin tonë , për vështirësitë të cilat janë paraqitur kemi bashkëpunuar dhe konsultuar me Divizionin e Shërbimeve Sociale pranë DPSF -së me IPS si dhe me të gjitha QPS-ët me të cilat jemi angazhuar në bashkëpunim në kryerjen e lëndëve të ndryshme .

Gjatë këtij viti të gjithë Zyrtarë e Shërbimit Social kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga DPSF në projektin e grupit të Helsinkut me temën Mbrojtja Sociale në Kosovë. Vlen të theksohet se kemi pasur një bashkëpunim me OJQ-ët, gjykatat, policinë dhe me shkollat.

Shërbimi Social në QPS-në në Kaçanik ka 2 punëtor , ku të gjithë janë me përgatitje universitare, me strukturë gjinore janë të gjithë meshkuj të kombësisë shqiptar.

## **INSPEKTORI SANITAR**

Për mos respektim të Ligjit Nr.03/L-016 Për Ushqimin , dhe shkeljeve të normave sanitare dhe mos respektim të vendimeve ,janë gjobitur me dënime mandatore . 10 operator ekonomik, kurse nga gjykata për kundravajtje është shqiptuar një gjobë dhe dy lëndë janë në procedurë.

Në bashkëpunim me Inspektorin e tregut janë lëshuar 38 pëlqime mbi plotësimin e kushteve teknike, higjieno –sanitare të objekteve për zhvillimin e veprimtarie tregtare .

Në procedurën e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve janë lëshuar 8 pëlqime mbi harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro-teknike të ndërtimit .

Bazuar në U/A(shëndetësi ) Nr.14/2013 Për Qarkulluesit me pakicë për produktet dhe pajisjet medicinale ,Ligji Nr.04/L-125 Për Shëndetësi ,U/A 08/2014 ,në procedurën e licencimit janë lëshuar 3 Aktvendime mbi plotësimin e kushteve higjieno –teknike dhe sanitare të barnatoreve dhe ordinancave private shëndetësore, si je janë shqiptuar tre gjoba mandatore për mos respektim të vendimit të inspektorit sanitar .

Për mos respektim të Ligjit Nr. 04/L-156 Për kontrollin e duhanit, U/A (shëndetësi ) Nr.09/2015 Mjediset pa tym duhani, janë shqiptuar gjoba mandatore 4 personave fizik ,pranë Gjykatës themelore –divizioni për kundërvajtje ,inspektori sanitar ka parashtruar 2 kërkesa për shqiptimin e masave ndëshkuese konform dispozitave Ligjore në fuqi .

Bazuar në Ligjin nr.02/L-109 –Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, janë lëshuar 40 vendime për kryerjen e kontrollit shëndetësor ndaj bacilbartjes për punëtorët që vijnë në kontakt të drejtpërdrejt me ushqimin, furnizim të popullatës me ujë të pijshëm, me barna farmaceutike, mjekimin e pacientëve etj.

Artikujt ushqimor që nuk i kanë përbush kushtet për konsum dhe që i ka skaduar afati i përqendrueshmërisë janë asgjësuar, ku vlera e artikujve është 7.580 €.

Janë lëshuar dy aktvendime për rivarrimin e personave të vdekur.

Janë inspektuar të gjitha objektet edukativo – arsimore ,  
( kushtet higjieno –sanitare janë në nivel mesatar ) .

Është bërë inspektimi i të gjitha objekteve hoteliere dhe me këtë rast është bërë edhe depistimi i këtyre objekteve dhe janë marrë disa strisho për ekzaminim mikrobiologjik – ku mund të theksohet se strishot e marra kanë rezultuar në nivelin e kënaqshëm .

Gjatë vitit 2018 nga Instituti Rgjional-Ferizaj janë analizuar 4 mostra kimike dhe 4 mostra bakterologjike të ujit të pijshëm, sipas kërkesave të qytetarëve.

Gjatë kësaj periudhe kemi pas bashkëpunim të ngushtë me IKSHP-rajonal –Ferizaj ,AUV-së, Gjykatën Komunale dhe Policinë e Kosovës.

### Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

#### Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti Arritjet/progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2018

Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2018
1.Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor;	1.- Në 12 shkolla amë fillore e të mesme të ulëta funksionojnë paralelet parafillore, ndërkohë që në këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 488 fëmijë të shpërndarë në 27 paralele. Vlen të theksohet se sivjet janë hapur edhe dy paralele për fëmijët parafilor; në Runjevë, paralele e ndarë e SHFMU “Emin Duraku” dhe në Strazhë, paralele e ndarë e SHFMU “Dituria”. Përmes organizimit të këtij niveli shkollor synojmë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo fëmije, ndërkaq që në klasën e parë, në fillim të vitit shkollor 2018\2019 janë regjistruar gjithsej 527 fëmijë.

<p>2.Ngritja e cilësisë - Zbatimi i plan-programit mësimor; përgatitja e dosjeve (portofolio) me shkrim e mësimdhënësve për orë mësimore</p>	<p>2.- Implementimi i reformave në mësimdhënie dhe nxënie, me theks të veçantë zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversitar) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë.</p> <p>Ngritja e cilësisë mbetet prioritet bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve por edhe ngritjen e përpjekjeve dhe përgjegjësisë në punë. Gjatë fundit të gushtit të vitit 2018 janë trajnuar afër 115 mësimdhënës të shkollave tona për zbatimin e Kornizës Kurrikulare në Kosovë të cilët janë në zbatim të këtij programi të ri shkollor. Ndërkaq, edhe përgatitja e dosjeve (portofolio) të mësimdhënësve për fushat: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë, Shkenca të Natyrës, Shoqëria dhe Mjedisit dhe Mësimi Klasor, po ashtu ka qenë në funksion të ngritjes së cilësisë dhe zbatimit të Kurrikulës së re.</p>
<p>3.Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë</p>	<p>3.- Ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, respektivisht sipas kurrikulës së re i bazuar në rezultatet e të nxënësit për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore.</p> <p>Në afatin e qershorit, në fund të vitit mësimor 2017-2018, testit të maturës i janë nënshtruar gjithsej 440 maturantë të dy shkollave të mesme të larta. Në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 268 nxënës maturant, provimit të maturës iu janë nënshtruar gjithsej 263, ndërsa rezultat pozitiv kanë treguar 245 prej tyre apo 93,15 %. Ndërkaq, në SHMP nga gjithsej 210 nxënës maturant, provimit të maturës iu janë nënshtruar 177 prej tyre, ndërsa testin e kanë kaluar vetëm 39 apo 22 %. Ndërkohë, që në afatin e dytë (të gushtit) në provimin e matyrës, nga të dy shkollat kanë hyrë 106 maturant, duke përfshirë edhe ata nga vitet e më hershme, ndërsa kanë kaluar 51 prej tyre apo 48,11 %. Gjatë vitit shkollor 2017-2018, në dy shkollat e mesme, mësimet i kanë vijuar 478 nxënës maturant, prej tyre 268 në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe 210 në SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”. Ndërkaq, Testit të Arritshmërisë në fund të vitit mësimor 2017-2018 iu janë nënshtruar 594 semimaturant nga 12 shkolla amë fillore e të mesme të ulëta dhe 7 paralele të ndara fizike, të cilat e kanë përfunduar klasën e nëntë. Semimaturantët kaçanikas kanë arritur</p>

	<p>rezultate relativisht të mira duke arritur nivelin e kalueshmërsë në shkallë komune prej 52.70 % e që krahasuar me vitin paraprak (46,37 %) është shënuar ngritje për afër 6,33 %.</p>
<p>4.Trajnimi i mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare .</p>	<p>4.- Janë trajnuar afër 115 mësimdhënës në fushat: Gjuhë dhe Komunikim, Matematikë, Shkenca të Natyrës, Shoqëria dhe Mjediti, Mësimi Klasor, Edukimi Fizik, Artet dhe Jeta e Puna. Mësimdhënësit e trajnuar janë angazhuar në klasat 1,2, 6 e 7 në shkolla fillore e te mesme të ulëta dhe klasat 10 e 11 në Gjimnaz.</p>
<p>5.Funksionimi i organeve të shkollës: Këshilli Drejtues i Shkollës, Aktivitet Profesional, Koordinatorët e cilësisë dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit,</p>	<p>5.- Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, ndarja e punëve dhe përgjegjësisë në përputhje me rolin e tyre .  - Koordinatorët e përzgjedhur janë angazhuar në sigurimin e cilësisë përmes procesit të planifikimit gjithëpërfshirës ku janë pasqyruar nevojat dhe prioritetet e shkollave dhe në përgjithësi zhvillimin e arsimit, ndërsa Ekipet për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit si mekanizëm parandalues është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.</p>

<p>6.Zhvillimi i aktiviteteve shkollore e jashtëmësimore .</p>	<p>6.Mbajtja e garave të diturisë në nivele të ndryshme: Olimpiada 2018 e Matematikës së Kosovës, për klasat 9, 10, 11 dhe 12 dhe Olimpiada e Fizikanëve të Kosovës 2018, për klasat 9, 10, 11 dhe 12, mbajtur në Departamentin e Fizikës, Garat shkollore në nivel komunal me rastin e Ditës së Çlirimit në 7 lëndë mësimore: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Kimi, Fizikë, Biologji, Gjeografi dhe Histori. Nxënësit pjesëmarrës në të gjitha garat, kanë treguar rezultatet të kënaqshme, ndërsa janë organizuar me qëllim të nxitjes së nxënësve për thellimin e njohurive të tyre. Po ashtu, për çdo vit organizohen dhe mbahen edhe garat shkollore të tjera (sportive) me qëllim të zhvillimit të shkathtësive etj, ndërsa nxënësit e shkollave të Komunës sonë marrin pjesë edhe në garat që organizohen në nivel vendi. Vlen të veçohen edhe garat në nivel komunal e Republikan në futboll e sporte tjera, të cilat kanë ndikuar në masovizimin e sporteve dhe kulturës fizike tek nxënësit.</p>
<p>7.Investimet në objektet shkollore</p>	<p>7.Gjatë vitit 2018 ka vazhduar ndërtimi i 3 objekte të reja shkollore: në Kaçanik të Vjetër, Gllboçicë e Kovaçec e po ashtu, ka vazhduar edhe ndërtimi i objektit të çerdhes së re për fëmijë në Kaçanik i filluar një vit më parë. Në Gjinnazin “Skënderbeu” është realizuar projekti “Masat e efijencës së energjisë” i financuar nga MZHE, në vlerë rreth 160 mijë euro. MASHT në vlerën e përgjithshme prej 73,000 euro ka realizuar disa projekte si në objektin e shkollës “Jusuf Gërvalla” në Biçec ku është rregulluar aneksi shkollor, hapësira ku është vendosur kalldaja e ngrohjes me avull, ndërsa në shkollën e fshatit Nikaj është renovuar kulmi, fasadimi e izolimi i pjesës së objektit të vjetër dhe rrethoja e oborrit shkollor. Në shkollën e fshatit Runjevë është bërë rregullimi i oborrit dhe është ndërtuar fusha sportive dhe në shkollën e fshatit Bajnice është ndërtuar aneksi shkollor dhe fusha sportive. Ndërkaq, investime për rregullimin e objekteve shkollore janë bërë edhe nga buxheti i Komunës në shumën e përgjithshme prej 35,768 euro ku në SHFMU “Emin Duraku” në objektin e vjetër janë riparuar shkallët e hyrjes dhe rregullimi i sallës së edukatës fizike, në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob, në shkollën amë është shtruar me linoleum dyshemeja e klasave, ndërkohë që është ndërtuar ndriçimi në fushën sportive. Po ashtu, me linoleum është shtruar edhe dyshemeja e klasave në SHFMU “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër (objekti në Fushë të</p>

	<p>Pajtimet) dhe në SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj është rregullua salla e arsimitarëve dhe nyjet sanitare, ndërsa në shkollën 4 klasëshe të Provolisë (SHFMU “Kadri Zeka” ) është bërë ndërrimi i dritareve, ljerja e brendshme e objektit dhe rregullimi i nyjeve sanitare e në SHFMU “Agim Bajrami” në Stagovë janë ndërruar dyert e klasave të pjesës së vjetër të shkollës dhe është shtruar me linoleum dysHEMEJA, ndërkohë që është rregulluar edhe një pjesë e trotuarit, ndërkohë në Gjymnazin “ Skënderbeu” janë shtruar dysHEMETË e klasave dhe palestrës sportive me linoleum.</p>
<b>Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti</b>	<b>Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2018</b>
Zbatimi i Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore - PLTK	Institucionet qendrore, respektivisht Instituti arkeologjik në bashkëpunim me nivelin lokal janë angazhuar për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në komunën tonë .
<b>Prioriteti 8: Përmirësimi i aktivitetet rinore</b>	
<b>Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti</b>	<b>Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2018</b>
Shënimi i datave të rëndësishme për rininë	Me mjete financiare janë mbështetur aktivitetet rinore duke i përfshirë një varg aktivitetesh sportive e aktivitetet tjera nga fusha të ndryshme. Njëkohësisht, është arritur të bëhet masivizimi dhe ngritja në nivel më të lartë i aktiviteteve rinore – sportive. Fuqizimi i KVRL përmes aktiviteteve si dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu janë organizuar edhe vizita studimore jashtë vendit ( Irlandë)
Organizimi i aktiviteteve kulturore	Përmes organizimit të Festivalit të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Kaçaniku 2018, të XXIX me radhë është arritur të ruhen vlerat kulturore. Është ruajtur tradita e këngëve dhe valleve popullore që kultivohen në trojet shqiptare. Gjithashtu janë mbështetur edhe organizatat kulturore që veprojnë në Komunën tonë në mbarëvajtjen e aktiviteteve të tyre.
Organizimi i aktiviteteve sportive	Janë organizuar turne të ndryshëm me rastin e datave të rëndësishme vendore, kombëtare e ndërkombëtare me që rast krahas këtyre aktiviteteve është bërë edhe identifikimi dhe promovimi i talenteve të rinjë për aktivitetet sportive .Gjithashtu janë mbështetur edhe klubet sportive që veprojnë në komunën tonë për mbajtjen e aktiviteteve ( garave ) të tyre vjetore.

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare në kuadër të Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike ka për qëllim raportimin për kryetarin e komunës, kuvendin komunal si dhe informimin e opinionit publik për punën e DESHP-së për periudhën Janar-Dhjetor 2018

### **I. INFRASTRUKTURA RRUGORE**

#### ➤ **Asfaltime të rrugëve lokale**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, në kuadër të përgjegjësisë dhe aktiviteteve të saja gjatë vitit 2018, fokus të veçantë i kushtoi realizimit të projekteve kapitale brenda listës së miratuar nga kuvendi komunal. Në bashkëpunim të ngushtë me zyrën e kryetarit dhe të drejtorive tjera është angazhuar për implementimin e projekteve të infrastrukturës rrugore të cilat janë paraqitur si vijon:

#### ➤ **Asfaltime dhe ndërtime të rrugëve lokale nga buxheti i komunës**

Gjatë kësaj periudhe, nga lista e investimeve kapitale me buxhetin e komunës janë realizuar gjithsej 19 projekte rrugësh të asfaltuar dhe ndërtuar me kubëza, ku gjatësia e rrugëve të ndërtuara arrin **11,010.46m**.

NR	EMËRTIMI I PROJEKTIT	Gjatësia e rrugës/m	Gjërësia e rrugës/m <sup>2</sup>
1	Ndërtimi i rrugëve në lagjen Hajdar	804.81	2,414.43
2	Ndërtimi i rrugëve në Begracë	1025	3,075
3	Ndërtimi i rrugëve në Kaçanik të Vjetër	1575	4,725
4	Ndërtimi i rrugëve në Ivajë	516	1,530
5	Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Bob	280	840
6	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kotlinë	1400	4200
7	Ndërtim i rrugëve në fshatin Stagovë	539	1,617
8	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Nikë	540	2,430
9	Asfaltimi i rrugës Gabrricë -Duraj	986	4,437
10	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Gllloboqicë	1121	3,363
11	Ndërtimi rrugëve në lagjën Neziraj	674.8	2,024.4
12	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gërllicë-faza IV	370	1,110
13	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biqec	373	1,119

14	Rregullimi i rrugëve në fshatin Kovaqec	170	510
15	Ndërtimi i rrugëve në Runjevë	146	438
16	Rregullim i rrugëve në lagjen Dushkaja	489.85	1,469.55
17	Asfaltimi i rrugës "Terziu"-Doganaj-fazal/traseja		
18	Rregullim i rrugëve në fshatin Gajre-faza I/muret mbajtëse		
19	Ndërtim i rrugës "Shaban Elezi"-fazal/traseja		
	<b>Total</b>	<b>11,010.46m</b>	<b>35,302.38m<sup>2</sup></b>

Poashtu në kuadër të projektit të drejtorisë për zhvillim ekonomik "Rregullimi dhe asfaltim i rrugëve lokale" janë implementuar edhe 6 rrugë tjera me shtresë asfalti dhe kubëza në gjatësi=875m

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m	Gjerësia/m <sup>2</sup>
1.	Rruga "Martirët"-Stagovë	218m	654
2.	Rruga "Imer Elezi"-Kaçanik	84m	252
3	Rruga "Ali Baftiu"-Dubrave	195m	585
4	Rruga "Ekrem Ahmetaj"-Kovaqec	210m	630
5	Degëzim i rr."Besnik Begunca"	92m	276
6	Degëzim i rr."Faruk Dogani" në Rakoc.	76m	228
	<b>Total</b>	<b>875m</b>	<b>2,625m<sup>2</sup></b>

Gjithashtu përmes nënshkrimit të memorandumeve me ministritë e ndryshme dhe me bashkëfinancim të komunës janë realizuar edhe projekte tjera në infrastrukturën rrugore.

➤ **Asfaltime të rrugëve lokale nga Ministria e Infrastrukturës 2017-2018**

Ministria e infrastrukturës financoon këto projekte më shumë 214,354.81€ kurse komuna bashkëfinancoon vlerën 10% të kontratës me shumë=21,205.20€. Totali i kontratës=235,560.01€

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m	Gjerësia/m <sup>2</sup>
1.	Rruga "Lushi"-Doganaj	1911	7,644
2.	Rruga"Rezhanc-Dullovi	599	2,396
3	Rruga "Liria"-Gërlicë	485	1940

4	Rruga "Razim Hasaj"-Gabrricë	750	3000
5	Rruga e lagjes Trupaj-Kovaqec		
	Total	<b>3,745m</b>	<b>14,980m<sup>2</sup></b>

➤ **Asfaltim dhe rregullim i rrugëve nga Ministria e Infrastrukturës 2018-2019**



Janë duke u implementuar edhe 9 projekte në infrastrukturën rrugore, disa duke u përgatitur traseja si fazë e I-rë, për të vazhduar me shtresën e asfaltit në vitin 2019 në gjatësi=4,143m apo 14,209m<sup>2</sup>

Nr.	Emërtimi	Gjatësia	Gjerësia
1.	Rruga "Prushi"-K. Vjetër	350	1,050
2.	Rruga "Iliria"-Elezaj	206	618
3	Rruga "Pishtarët e Lirisë"-Elezaj	435	1,305
4	Rruga"Man Dashi"-Stagovë	400	1,200
5	Rruga"Adem Dullovi"-Vataj	312	936
6	Rruga"Xhevë dhe Fehmi Ldrovci-lagjja Kok /Runjevë	220	660
7	Rruga e lagjes Brruti-Kaçanik	230	690
8	Rruga"Arbëria"-Kaçanik	210	630
9	Rruga "Mujedin Aliu"-K. Vjetër	1780	7,120
	Total	<b>4,143m</b>	<b>14,209m<sup>2</sup></b>

➤ **Asfaltim dhe rregullim i rrugëve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik**

Komuna e Kaçanikut ka përfituar edhe një projekt dhe ka nënshkruar memorandum me ME-në .Ky projekt është ekzekutuar në fshatin Begracë.

Nr.	Emërtimi	Gjatësia	Gjerësia
1.	Ndërtimi i rrugës në lagjen Fejza-Begracë	2,300m	8,050m <sup>2</sup>

➤ **Ndërtimi i rrugëve lokale në bashkëfinancim me Ministrinë e infrastrukturës 2017-2018.**

Ne bashkëpunim me MI-në, gjatë vitit 2017 janë duke u implementuar edhe 14 rrugë dhe rruçicave në qytetin e Kaçanikut. Projekti është 2 vjeçar dhe ka vazhduar implementimi i saj edhe në vitin 2018.

<i>NR.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Gjatësia/m</i>	<i>Gjatësia/m<sup>2</sup></i>
1	Rruga "Nexhmush Elezi"-Kaçanik	256.50	768m <sup>2</sup>
2.	Rruga "Selim Shehu"-Kaçanik	479.6m	1678m <sup>2</sup>
3.	Rruga "Burim Rexha"-Kaçanik	412m	1236m <sup>2</sup>
4	Rruga "Rushit Luta"-Kaçanik	142m	426m <sup>2</sup>
5	Rruga "Bajram Berisha"-Kaçanik	236.5m	827.75m <sup>2</sup>
6	Rruga "Migjeni"-Kaçanik	294m	882m <sup>2</sup>
7	Rruga "Ukë Meta"-Kaçanik	313m	1290m <sup>2</sup>
8	Rruga "Blerim Raka"-Kaçanik	198.50m	595.5m <sup>2</sup>
9	Rruga "Mejdi Dalloshi"-Kaçanik-Segmenti deri te "Tefik Raka	450m	1800m <sup>2</sup>
10	Rruga "Mejdi Dalloshi"-Kaçanik-Segmenti II-deri "tek doket shehri"	161m	483m <sup>2</sup>
11	Rruga "Kjani Bela"-Kaçanik	413m	1240m <sup>2</sup>
12	Rruga "Asim Vokshi"-Kaçanik	184m	552m <sup>2</sup>
13	Rruga "Veli Dema"-Kaçanik	Ne proces	Ne proces

14	Rruga "Voskopoja"-Kaçanik	186m	560m <sup>2</sup>
	Total	3,726m	12,338.25m <sup>2</sup>

#### ➤ Mirëmbajtja e rrugëve lokale

Gjatë vitit, DSHPE-ja është angazhuar në mirëmbajtjen sistematike të rrugëve egzistuese të cilat janë të asfaltuara dhe rrugëve të shtruara me shtresë zhavori. Me poshtë do të japim listën e të gjitha rrugëve në të cilat është intervenuar dhe janë rehabilituar me shtresë zhavori.

Nr.	Emërtimi i rrugës	Aktiviteti
1	Rruga "Veseli"-Stagovë	Është shtruar me zhavor
2	Rruga "Krraba"-Stagovë	Është shtruar me zhavor
3	Rruga në Semaj te Epërm	Është intervenuar me zhavor

## II. UJËSJELLËSI

#### ➤ Rregullimi i sistemit aktual të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit

Gjatë kësaj periudhe është vazhduar me projektin "Sanimi, rekonstrimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore për sistemin e ujësjellësit Nikaj, Dubravë, Doganaj, Elezaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër". Janë punuar 2 rezervuare. Rezervuari në fshatin Sllatinë 50m<sup>3</sup> dhe është finalizuar rezervuari 740m<sup>3</sup> në lagjen Prushaj/Soponicë, rezervuar që do të shërbej për lokalitetet Elezaj-Doganaj dhe Kaçanik i Vjetër . Gjithashtu janë punuar rrjet furnizuese në drejtim të fshatrave Dallosh, Kovaq, Tushaj, Demnik, Provoli, Elezaj, Terziu, Doganaj dhe Koxhaj.

- Po ashtu në bashkëpunim me kompaninë Bektel &Enka është ndërtuar edhe rezervuari i qytetit me kapacitet 1000m<sup>3</sup> për nevojat e qytetit të Kaçanikut.
- Kemi arritur që me mjetet buxhetore të komunës të realizojmë projektin "Furnizimin me gyp të ujësjellësit". Janë siguruar 5000m gyp Φ63 për nevojat e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Duraj.

## III. KANALIZIMET

#### ➤ Ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimeve

Në kuadër të kodi buxhetor "Ndërtim i kanalizimeve fekale dhe atmosferike"-janë realizuar 7 projekte të ndryshme në gjatësi totale =4,434.8m,si dhe kemi bere furnizim me gyp te kanalizimit ne gjatësi 2,941m

	<b>Emërtimi</b>	<b>Gjatësia</b>
1	Furnizim me gypa $\Phi$ 250 dhe 7 puseta ne Kotlinë	600m gyp
2	Furnizim me gypa $\Phi$ 250 dhe 2 puseta në Kaçanik	30m
3	Furnizim me gypa $\Phi$ 160 dhe 2 puseta në Prushaj	170m
4	Kanalizimi ne fshatin Kovaqec-lagja Koraq	250m
5	Kanalizimi ne fshatin Stagovë-lagjja Hysaj	93m
6	Furnizim me gypa $\Phi$ 315 në lagjen Kukaj	175m
7	Kanalizimi ne fshatin Stagovë-lagjja Teneq	285m
8	Kanalizimi ne lagjen Tushaj-Soponice	1666m
9	Furnizim me gypa $\Phi$ 315-Korbliq	60m
10	Furnizim me gypa $\Phi$ 250 dhe 5 puseta ne Ivajë	300m
11	Kanalizimi te lagjja Shavarin-K.Vjeter	1123.3m
12	Kanalizimi te lagjja e Reqëve-K.Vjeter	570m
13	Furnizim me gypa te Aqif Nallbani	60m
14	Furnizim me gypa ne Dushkajë	80m
15	Furnizim me gypa ne Trupaj	430m
16	Furnizim me gypa $\Phi$ 315 lagjja Hajdar-Dubravë	150m
17	Furnizim me gypa $\Phi$ 315 dhe $\Phi$ 200 te shkolla Kovaqec	60m+66m
18	Furnizim me gypa $\Phi$ 250 në lagjen Tifek-Lamaj	260m
19	Furnizim me gypa rr. Triumf Riza"Stagovë-	300m
20	Furnizim me gypa Bob-Veli Dema	200m
21	Kanalizimi te lagjja Krraba-Stagovë	447.50m
	<b>Total 2018</b>	<b>7,375.8m</b>

Poashtu në bashkëpunim me MMPH-në është finalizuar projekti "Ndërtimi i kanalizimit fekal Elezaj, Duraj, Gabrricë, Gërllicë, Bajnicë dhe Koxhaj" ne gjatësi rreth 28,813m/28km që lidh lagjet e lokalitetit të Elezajve dhe Doganajve .

➤ *Intervenimi në funksionalizimin e kanalizimeve fekale dhe atmosferike*

Sa i përket trajtimit të ujërave atmosferik në komunën e Kaçanikut, megjithëse ekziston një sistem i tillë në shumicën e rrugëve të ndërtuara, shumica prej tyre nuk funksionojnë, kështu duke shkaktuar probleme të theksuara në rrugë për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve, si dhe duke dëmtuar rrugët publike. Gjatë këtij viti kemi intervenuar në funksionalizimin e rrjetit fekal në Dubravë, Begracë, Kaçanik, ku kemi arritur të funksionalizojmë rrjetin e ujërave fekale. Edhe gjatë këtij viti që po hymë, planifikojmë të intervenojmë në shumicën e vendeve më problematike, si dhe të bëjmë zgjidhje për kapakët mbulues të tyre, të cilat vazhdimisht vidhen nga persona të pandërgjegjshëm.

#### IV. UJRAT SIPËRFAQËSOR

➤ **Investime në rrjetin e ri**

Gjatë këtij viti kemi investuar në ndërtimin e disa rrjeteve të ujrave atmosferike. Kemi ndërtuar rrjetin e kanalizimit te ujërave atmosferike në Biqec, Kovacec dhe lagjen Kovaqi-Soponicë të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese:

Emërtimi		Gjatësia
Rregullimi i përroit të lagjes Koraqi-Kovaqec		70m
Rregullimi i përroit në lagjen Kovaq në fsh.Doganaj-faza II		75m
Rregullimi i kanalit për ujra atmosferik në lagjen Bunjak/Biqec		243m
<b>Totali</b>		<b>388m</b>

➤ **Intervenimi në funksionalizimin e kanalizimeve atmosferike**

Gjatë këtij viti ne kemi intervenuar në funksionalizimin e rrjetit atmosferik në Bob, Rakoc dhe Kukaj , ku kemi arritur të funksionalizojme rrjetin e ujrave atmosferik. Kemi vendosur kapakët e

pusetave në rrugën “Dëshmorët e Lirisë”-Dushkajë. Edhe gjatë këtij viti që po hymë, planifikojmë të intervenojmë në shumicën e përrockave dhe sistemeve të rrjetit të ujrave atmosferike më problematike, si dhe të bëjmë zgjidhje për kapakët mbulues të tyre, të cilat vazhdimisht vidhen nga persona të pandërgjegjshëm.

## V. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Gjatë këtij viti jemi fokusuar në implementimin e Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2016-2021.

Kemi realizuar projektin “**Furnizimit me shporta për mbeturina 120l**”.Janë siguruar gjithsej **2300** shporta 120l, Këto kontejnerë do të shfrytëzohen me qëllim të rritjes së mbulueshmërisë së territorit të komunës sonë me menaxhim të mbeturinave.

Gjithashtu kemi vazhduar me implementimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes GIZ-it dhe Komunës së Kaçanikut lidhur me pilot projektet në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe implementimit të projektit “Gara për Mjedis të Pastër” ku kemi fituar grandin në shumë 137,381.00€ (66,808.00€-për kriteret e qasjes dhe 70,573.00€ shpërblimi në grup). Këto mjete do t'i përdorim për investime në makineri me qëllim të rritjes së mbulueshmërisë së territorit të komunës sonë me menaxhim të mbeturinave dhe përmbushjen e objektivave që dalin nga Plani komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021.

## VI. KOMUNIKACIONI RRUGOR

### ➤ **Shenjëzimi Horizontal dhe Vertikal**

Gjatë vitit 2018 kemi projektuar dhe realizuar projekti “**Shenjëzimi horizontal dhe vertikal**” në disa rrugë të territorit të komunës së Kaçanikut. Poashtu janë vendosur barriera për ngadalësim të shpejtësisë (policë të shtrirë) dhe pahi elastike në rrugët lokale ku është evidentuar me rrezikshmëri të lartë.

### ➤ **Funksionimi i rregullt i linjave të transportit publik**

Transporti publik i udhëtarëve në komunën tonë gjatë këtij viti ka funksionuar mirë. Gjatë vitit jemi fokusuar në zbatimin e rregullores komunale për transportin publik. Janë pajisur të gjithë operatorët me autobus, kombi-bus dhe auto taksi me leje pune dhe janë vërtetuar rendet e udhëtimit për linjat urbano-periferike. Aktualisht funksionon transporti publik i udhëtarëve në të gjitha vijat të cilat janë shpallur nga DSHPF-ja.

## VII. TELEKOMUNIKIMET

### ➤ Ofrimit i shërbimeve të internetit dhe kabllorikut

Gjatë vitit 2018 kemi përcjellë operimin e operatorëve të licensuar për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese – internet dhe shërbimeve televizive – kabllorik, të cilët tani më kanë filluar ndërtimin e rrjetit të tyre si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve në lokalitetet ku kanë aplikuar për operim. Kemi kërkuar që të bëhet shtrirja e rrjetit në të gjitha lokalitetet që kanë ofertuar për operim.

## VIII. HAPËSIRAT PUBLIKE

### ➤ Gjelbërimi dhe Parqet

Në kuadër të projektit “**Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe vendosja e shportave**” është bërë rregullimi i hapësirës së gjelbëruar në lagjen Dushkajë, vendi ku më parë ishte deponi ilegale, si dhe është punuar hapësira e gjelbëruar pranë banesës afër urës së Bobit.

Poashtu është realizuar edhe projekti “**Renovimi i ulëseve dhe punimi i rrethojës së hyrje të qytetit**”.

### ➤ Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave

Gjatë vitit 2018 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i varrezave të dëshmorëve, posaçërisht pra çdo datë të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjët dekorativ.

Poashtu është realizuar projekti “**Rregullimi i varrezave të qytetit**”-faza III

### ➤ Trotuare dhe ura

Gjatë vitit 2018 në kuadër të investimeve kapitale janë ndërtuar edhe 4 projekte të trotuarëve për këmbësor me një gjatësi totale **2,594m**

Ndërtimi i trotuarit në fshatin Bajnicë	1000m
Ndërtimi i trotuarit ne lagjen Imishti-Dubravë	1200m
Ndërtimi i trotuarit në rrugën “Komandant Bardhi”	224m
Ndërtimi i trotuarit ne lagjen Provoli-Soponicë	170m
<b>TOTALI</b>	<b>2,594m</b>

Poashtu është bërë ndërtimi i 2 urave të reja mbi lumin Nerodime dhe Lepenc si dhe është implementuar projekti i zgjerimit të urës së Hazirit dhe urës në rrugën “Vëllezërit Çaka”.

Nr	Emërtimi i projektit
1	Ndërtimi i urës dhe rrugës mbi lumin Nerodime-Runjevë
2	Ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc-lagjja Dallosh
3	Zgjerimi i urës së Hazirit dhe urës në rr. "VII.Çaka"

## IX. NDRIÇIMI PUBLIK

### ➤ **Mirëmbajte e rrjetit ekzistues**

Gjatë vitit 2018 kemi bërë mirëmbajtjen sistematike të rrjetit të ndriçimit publik duke intervenuar në sanimin e defekteve dhe ndërrimin e trupave ndriçues ndërsa gjithashtu kemi bërë edhe zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik në zona të qytetit ku nuk ka pasur ndriçim. Kemi zgjeruar rrjetin e ndriçimit publik në rrugët e zonës urbane të qytetit dhe në lagjet periferike (Dushkajë dhe Bob)

### ➤ **Investimet**

Projekti kapital **"Rregullimi i ndriçimit publik"** me vlerë **21,670.12€** është ekzekutuar në këto rrugë:

1. Rruga "Ismjl Raka"-Kaçanik -64 trupa ndriçues janë ndërruar me LED
2. Rruga "Agim Bajrami"- 6 trupa ndriçues janë ndërruar me LED
3. Rruga "Avdurrahim Shehu"-janë vendosur 45 trupa ndriçues LED
4. Rruga "Faruk Dogani"- janë vendosur 12 trupa ndriçues LED
5. Rruga "Medi Dalloshi"-janë vendosur 6 trupa ndriçues LED
6. Rruga "Shefket Ferra"-Kaçanik- janë vendosur 8 trupa ndriçues LED
7. Rruga "Ejup Dushkaja"-Dushkajë- janë vendosur 15 trupa ndriçues LED
8. Rruga "Remzi Zharku"-Dushkajë"- janë vendosur 4 trupa ndriçues LED

- Projekti **"Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Bob"**-është realizuar edhe ndriçimi në këtë lagje duke vendosur 68 trupa ndriçues në rrugën kryesore dhe rrugët sekondare.
- Projekti **"Furnizimi, ndërrimi dhe rregullimi i ndriçimit publik"** në vlerë **8,660€**. Janë zëvendësuar **122 trupa ndriçues** ekzistues të teknologjisë së vjetër me trupa të rinj eficient të tipit I.E.D.

Rrugët e përfshira në këtë projekt:

1. Rruga "Skenderbeu"
2. Rr. "Emsale Frangu"
3. Rr. Qamil Ilazi"
4. Rr. "Sali Bajra"
5. Rr. "Besnik Begunca"
6. Rr. "Idriz Seferi"
7. Rr. "Vëllezërit Çaka"
8. Rr. "Reshat Shehu"
9. Rr. "Nevzat Çallaku"

Gjatë vitit 2018 kemi dhënë edhe 3 leje për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik ( investim vetanak i komunitetit ), në lagjen Selman-Doganaj, lagjen Dalloshi-Soponicë dhe lagjen Topalli-Soponicë. Pas implementimit të këtyre projekteve, DSHPE-ja ka marrë përsipër shpenzimin mujor të rrymës e rrymës.

## **X. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE**

### **➤ Bashkëpunimi i punëve me KKSBB-në**

Gjatë vitit 2018 kemi marrë pjesë në takime me Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi. Është diskutuar në përgjithësi rreth gjendjes së sigurisë në territorin e komunës sonë, ku ne si drejtori kemi dhënë kontributin tone në zgjidhjen e problemeve të ndryshme të ngritura nga anëtarët e KKSBB-së të cilat kanë qenë të ndërlidhura me detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë sonë.

### **➤ Intervenimi në situata emergjente**

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur shumë situata emergjente të cilat kanë kërkuar intervenim të menjëhershëm, për të siguruar kryesisht rrugët, pronën publike dhe private si dhe jetën e njerëzve. Është hartuar dhe miratuar në kuvend komunal Plani komunal i mbrojtjes nga zjarri si është bërë evidentim i përrockave dhe rrezikut të tyre nga vërshimet si dhe kostoja e tyre për pastrimin nga mbeturinat dhe barnishtet e ndryshme. Kemi ndërtuar mure mbrojtëse në rrugën "Tefik Raka"-Kaçanik, rrugën "Mukadeze Lika-Muhaxheri" dhe në fshatin Gajre për sanimin e rrezikut të shembjes së rrugësve. Gjithashtu kemi asistuar në aksionet emergjente të kërkim-shpëtimit në fshatin Shtrazë, Begracë ( kërkim për persona të zhdukur) dhe kërkimi i 2 policëve

të rënë në lumin Lepenc nga aksidenti në rrugën magjistrale. Poashtu gjatë të reshurave, në fillim të këtij viti, stafi i drejtorisë dhe ekipet e emergjencës, në bashkëpunim me kompaninë Bechtel&Enka dhe kompaninë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, janë angazhuar në situatat e krijuara nga vërshimet siq janë; zhbllokimi i tombonës në bulevardin e qytetit, përroit në lagjen Kukaj dhe lokacione tjera të rrezikuara vërshimet dhe shembjet e ndryshme.

### Investimet nga rezultatet e Grandit të Performancës

- Raportimi në MAPL për treguesit shtesë të performancës komunale për vitin 2016, ku komuna e Kaçanikut ka arrit që për këta tregues të performancës të vlerësohet.

Shuma e grantit të performancës që komuna jonë ka përfituar për treguesit e performancës shtesë për 2016, është **84,138.00€**. Këto mjete u investuan në dy projekte: "Ndërtimi i trotuarit në lagjen Imisht"-Dubravë dhe "Zgjerimi i urës mbi lumin Nerodime dhe Lepenc"

- Raportimi për performancën komunale të vitit 2017 ka përfunduar më 14 shkurt të vitit 2018, për 14 fushat e përcaktuara nga MAPL-ja.

Shuma e grantit të performancës që komuna e Kaçanikut ka përfituar është **104,268.00€**, alokim i grantit për vitin 2019. Këto mjete do të investohen në projektin "Rregullimi i rrugëve në zonën urbane të qytetit" në vitin 2019.

STATISTIKA		
1	Asfaltim të rrugëve lokale me buxhet komunal	37,927.38m <sup>2</sup>
2	Asfaltim të rrugëve lokale me bashkëfinancim nga ministritë e linjës	34,597.25m <sup>2</sup>
3	Ndërtimi i kanalizimeve fekale	36,188.98 m
4	Ndërtimi i kanaleve të hapura për ujra atmosferike (shtretër të përrockave)	388 m
5	Ndërtim i trotuareve	2,594 m
6	Riparimi i rrugëve të asfaltuara	120 m <sup>2</sup>
7	Rehabilitimi i rrugëve publike të pakategorizuara me shtresë zhavori	3 projekte
8	Krijim i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ	1 projekt
9	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	1 projekt

10	Ndriçimi publik	350 trupa
11	Ndërtim i urave	3 projekte
12	Furnizim me gyp ujësjiellësi Ø 63	5,000 m
13	Ndërtim i murit mbajtës	3 projekte
14	Renovimi i ulëseve dhe punimi i rrethojës në hyrje të qytetit	1 projekt
15	Furnizim me shporta për mbeturina	2,300 cp

**Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik**

**Buxheti për vitin 2018**

Përmes ndarjeve buxhetore për secilin sektor komunal është arritur që edhe të realizohen në përpikëri gjitha aktivitetet komunale si në aspektin e realizimit të projekteve kapitale, mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve, shpenzimeve komunale dhe pagave e mëditjeve.

**Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Komunën e Kaçanikut**  
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

Shenime	2018		2017		2016		
	Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit		
	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	
	'000	'000	'000	'000	'000	'000	
<b>BURIMET E FONDEVE</b>							
Granti qeveritar	7.157,204	-	6.119,686	-	6.004,937	-	
Të hyrat vetanake	543,665	-	540,913	-	634,084	-	
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-	-	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	91,138	-	52,715,00	-	12,188	-	
Huamarrjet	19,286	-	-	-	-	-	
Fondi zhvillimor në mirëbesim	-	-	-	-	-	-	
Pranimet tjera	-	-	-	-	-	-	
<b>Gjithsej</b>	<b>7,811,294</b>	<b>-</b>	<b>6,713,314</b>	<b>-</b>	<b>6,651,210</b>	<b>-</b>	
<b>SHFRYTEZIMI I FONDEVE</b>							
<b>Operacional</b>							
Paga dhe roga	2	4,925,423	4,764,649	-	4,811,836	-	
Malira dhe shërbime	3	823,679	490,398	-	504,543	-	
Shpenzime komunale	4	110,318	117,200	-	116,053	-	
		<u>5,859,420</u>	<u>5,372,247</u>	<u>-</u>	<u>5,432,431</u>	<u>-</u>	
<b>Transferet</b>							
Transfere dhe subvencione	5	306,772	161,228	-	204,270	-	
<b>Shpenzime kapitale</b>							
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	1,645,101	1,179,839	-	1,014,508	-	
Kitimi i huamarrjeve	7	-	-	-	-	-	
Pagesa tjera	8	-	-	-	-	-	
<b>Gjithsej</b>		<b>7,811,293.67</b>	<b># -</b>	<b># 6,713,313.81</b>	<b># -</b>	<b># 6,651,209.66</b>	<b># -</b>

### Tatimi në Pronë

Zyra e Tatimit në prone në bazë të Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2018 -nr.01-Nr.104/02-30543/17 ka bërë përgatitjen dhe hartimin e planit për shtypjen dhe shpërndarjen e faturave të tatimit për vitin 2018. Pos punëve të përditshme Zyra e tatimit në pronë ka filluar shtypjen e faturave tatimore me **11.01.2018** dhe atë për secilën Zonë Kadastrale, pra për 29 zona kadastrale .Numri i faturave të shtypura është 9029 në vlerë prej 272.034,61€. Në vazhdimësi me shtypjen e faturave kemi filluar edhe shpërndarjen e tyre nëpër adresa të pronës e që të njëjtat janë shpërndarë brenda afatit ligjor që është 31 Marsi, ndërsa vlen të theksohet se për shpërndarjen e tyre kemi angazhuar dy(2) punëtor shtesë dhe se faturat janë shpërndarë me kohë.

Menjëherë pas fillimit të shpërndarjes së faturave tatimore ka filluar edhe procedura e ankesave dhe atë: **a)** Nëse si rezultat i shënimeve të pasakta, vlerësimi i pronës nuk është i drejtë; **b)** Vlerësim të gabuar të pronës; **c)** Matje të gabuara; **d)** Normë tatimore e pasaktë, bazuar në shfrytëzimin e pronës; **e)** Zbatimi i gabuar i nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-204, “Për tatimin në pronën e paluajtshme”, lidhur me lirimin nga tatimi në pronën e paluajtshme; **f)** Përcaktim i pasaktë i zonës tatimore për vlerësim; dhe **g)** Nëse fatura e tatimit në pronë është nxjerre në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-204 “Për tatimin në pronën e paluajtshme”.

Gjatë afatit të ankesave nga 07-30.04/2018 Zyra e tatimit në pronë ka pranuar 131 ankesa dhe atë sipas kategorive të pronës 82 ankesa për objekte banimi, 2 objekte bujqësore, 5 objekte të papërfunduara, 29 objekte për afarizëm, 1 objekte-garazhe dhe 12 objekte depo-industri dhe pas kalimit të afatit ligjor ka arritur edhe një ankesë.

Të gjitha ankesat e arritura janë vizituar nga anketuesit e ZTP dhe janë shqyrtuar brenda afatit ligjor nga Bordi Komunal i ankesave i formuar nga Kryetari i Komunës dhe atë 110 ankesa janë aprovuar dhe 22 janë refuzuar.

Ka vazhduar të qëndrojë e hapur ekspozita “Sa vlen toka juaj” me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me vlerat e tokave të tyre pasi që në vitin vijues do të tatimohen edhe për tokat për të cilat nga MF-Departamenti i Tatimit në Pronë kemi marr Raportin mbi vlerësimin e përgjithshëm për komunën tonë e që do të jetë bazë për ngarkimin me tatim.

Gjatë vitit 2018 janë paguar gjithsej 5083 fatura në vlere prej 244.876.63 € shumë e cila është rritur për 5,026% në krahasim me vitin paraprak .

Në fillim të vitit 2018 është hartuar edhe plani i rianketimit, i cili është zbatuar pjesërisht nga 3010 prona të cilat është dashur të rianketohen.

Gjatë këtij viti nga dt.03.01.-30.11.2018 janë rianketuar 1928 prona dhe janë regjistruar 315 prona të reja e që është një ngritje mjaftë e mirë 74,52%.

Është zbatuar Udhëzimi administrativ Nr.7/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në prone. Janë lëshuar një numër i konsiderueshëm i vërtetimeve që kanë të bëjnë me shërbimet e Kadastrave komunale, kërkesa për caktimin e kushteve urbanistike, kërkesave për leje ndërtimi si dhe kërkesa tjera që bëhen në këtë drejtori. Për taksën për regjistrimin e automjeteve motorike kemi lëshuar gjithsej 5036 vërtetime, si dhe për jo tatimpagues dhe për asistencë sociale janë lëshuar 1220 vërtetime.

#### **Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve – Punët e realizuara 2018:**

<b>BIZNESE TË REJA .....</b>	<b>78</b>
Pronarë të gjinisë mashkullore.....	68
Pronarë të gjinisë femerore.....	10
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.....	46
Biznese Individuale.....	32

**VEPRIMTARIA BIZNESEVE.....**

Tregti me shumicë dhe pakicë: riparim i mjeteve motorike me gjithsej .....	19
Akomodim dhe ushqime me gjithsej.....	15
Shërbime administrative mbështetëse .....	3
Ndërtimtaria .....	6
Industria përpunuese .....	14
Veprimtaritë tjera shërbyese .....	2
Transporti dhe magazinimi .....	5
Veprimtaritë profesionale dhe sportive .....	5
Veprimtaritë e patundshmërisë .....	2
Artet, argëtimet dhe rekreacionet .....	2
Arsimi .....	1
Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe punës sociale .....	1
Bujqësi ,pylltari dhe peshkim .....	2
Administrimi publik dhe mbrojtja: sigurimi social i detyrueshëm .....	1
<b>NDRYSHIME NE BIZNESE.....</b>	<b>23</b>
Bizneset Individuale.....	13
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.....	10
<b>SHUARJET E BIZNESEVE.....</b>	<b>15</b>
Biznese Individuale.....	15
Pronaret të gjinisë mashkullore.....	13
Pronarët të gjinisë femerore.....	02
<b>TAKSA VJETORË NE BIZNES.....</b>	<b>23</b>
Shuma ngarkuar.....	27200
Shuma inkasuar.....	7100
<b>VËRTETIMET.....</b>	<b>35</b>
ÇERTIFIKATA TË REJA.....	08
ÇERTIFIKATË DUBLIKATË.....	17
INFORMATAT E BIZNESIT.....	120
<b>TOTALI LËNDEVE.....</b>	<b>319</b>

#### Raporti i Inspektorit të Tregut:

➤ Inspektime për parandalimin e ekonomisë jo formale .....	50
➤ Pranime teknike .....	28
➤ Aktvendime .....	5
➤ Urdhëresa .....	32
➤ Njoftim dhe shkresa zyrtare.....	2
➤ Intervenime rreth vendosjes së orarit të punës dhe	

---

➤ **Zëvendësimi i zyrtarit të biznesit që nga muaji PRILL**  
➤ **Përgatitja e Orarit të kujdestarisë të Barnatoreve Farmaceutike gjatë tërë Vitit**

---

- Taksa në Biznes
  - Realizimi i të hyrave nga Taksa në biznes
  - Vërejtje me shkrim bizneseve të cilat nuk kanë paguar taksën në biznes
- Plan operativ për mbikëqyrjen e respektimit të kujdestarisë së natës nga Barnatoret Farmaceutike
  - Inspektim gjatë natës
- Inspektim së bashku me Inspektorët e ATK-së , me ç ‘rast kemi zhvendosur të gjitha subjektet nga qyteti të cilat bien ndesh me Ligjin e Lojërave të Fatit
  - Inspektim i përbashkët me ATK-në te Lotaria e Kosovës
- Plani Operativ lidhur me transportin e mallrave pa dokumente
  - Inspektimet janë kryer së bashku me Inspektorin Sanitar dhe Policinë
- Dalja dhe kontrollimi rreth respektimit të orarit të punës edhe gjatë natës në bashkëpunim me policinë.
- Inspektim i subjekteve të cilat veprojnë me karburante lidhur me licencat për gaz dhe karburant si dhe dokumentacionet tjera.
- Inspektim rreth zbatimit të ligjit për duhan .  
Largimi duhanit nga shitja në vende të ekspozuara  
Largimi i të gjitha produkteve ushqimore dhe jo ushqimore të ngjashme me duhanin
- Inspektimi i vendosjes së deklaracionit të artikujve ushqimorë
- Largimi i shitësve ambulant .

- Kontrollimi i të gjitha furrave të bukës në Komunën e Kaçanikut si dhe matja e peshës së bukës
- Kontrollimi i vendosjes së çmimeve për artikujt ushqimor
- Regjistrimi , shuarja dhe ndryshimi i bizneseve në QKRB
- Kontrollimi i cilësisë së mallit me Inspektorin sanitar dhe konfiskimi i mallit.

**Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë**

Aktivitete kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet /progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2018
<p>Shqyrtimi i kërkesave. Mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti komunës</p>	<p>Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen e kërkesave të tyre qytetarët janë informuar me kohë, gjithashtu kjo drejtori është angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve me mjete nga buxheti komunës, nga projektet e realizuara kanë përfituar <b>405</b> fermerë:</p> <p>* Nga projekti mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m<sup>2</sup> kanë përfituar 70 fermerë, shuma e mjeteve <b>27,961.50€</b>, participim i fermerëve <b>7,000.00€</b>. Nga projekti për mbështetje të fermerëve me koshere bletësh kanë përfituar 94 bletarë (382 koshere bletësh) , vlera projektit <b>11,976.00 €</b>, participimi i fermerëve <b>2,395.20€</b>, nga projekti për mbështetje të fermerëve me makinë mjelëse për lopë qumështore kanë përfituar 56 fermerë, vlera projektit <b>11,200.00€</b>, participimi i fermerëve <b>2,240.00€</b>. Nga projekti për mekanizëm bujqësor (freza për tërheqje me traktor kanë përfituar 47 fermerë, makina spërkatëse për kulturat lavërtare 24 fermerë dhe makina shpërndarëse të plehut mineral 19 fermerë), vlera projektit <b>47,302.80€</b>, participimi i fermerëve <b>7,883.80 €</b></p> <p>Nga projekti për mbështetjen e fermerëve për mbjellje vjeshtore – grurë, kanë përfituar 95 fermerë, të cilët janë mbështetur prej <b>75-150 €</b>, varësisht prej sipërfaqes së mbjellur, vlera e projektit <b>12,990.00€</b>.</p> <p>Këtë vit kemi realizuar edhe projektin për rregullimin e kanalit të ujitjes në lagja Vishaj, fshati Dubravë në gjatësi prej 920m. vlera e projektit <b>16,958.00 €</b></p> <p>Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 17 kërkesa, prej të cilave 8 janë të miratuara, 2 e refuzuara, 7 në proces për shqyrtimit. Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është <b>6819 m<sup>2</sup></b>. Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej <b>5,583.00€</b> .</p> <p>Janë shqyrtuar 58 kërkesa të natyrës së ndryshme prej të cilave 19 vlerësime për dëmet e shkaktuara nga Bechtelenka dhe 7 kërkesa tjera për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet e tokave bujqësore nga të reshurat e dendura dhe dëmet e shkaktuara nga egërsirat.</p> <p>Janë lëshuar 47 vërtetime lidhur me numrin e koshereve me bletë që posedojnë bletarët, për aplikim në subvencionet e MBZHRP, dhe dy vërtetim e fermerëve si dëshmi që merren me bujqësi, janë inkasuar <b>490€</b></p>

<p>Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale</p>	<p>Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike për temat e shtjelluara nga trajnimet e organizuara gjatë vitit 2018, 16 trajnime gjithsejtë 369 fermerë. Trajnimet janë organizuar me këto tema të cekuar me numër pjesëmarrësve siç vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Higjiena e qumështit- Mastiti (14)</li> <li>2. Mbarsimi artificial te kafshët (14)</li> <li>3. Përgatitja e kafshëve për kullosa (16)</li> <li>4. Kultivimi dhe rëndësia ekonomike e lajthisë dhe arrës (15)</li> <li>5. Kultivimi i gjedhit për mish(15)</li> <li>6. Sistemi ujitjes te bimët mjekësore(15)</li> <li>7. Roli dhe rëndësia e përdorimit të nënprodukteve në racionet ushqyese - (11)</li> <li>8. Konservimi i pemëve dhe perimeve dhe përgatitja e reçeli, mermeladës (12)</li> <li>9. SËMUNDJA GUNGORE TE GJEDHI - (15)</li> <li>10. Rëndësia e paketimit dhe etiketimit të produkteve ushqimore (vendore) (22)</li> <li>11. Të ushqyerit e gjedhit në bazë të ciklit prodhues (13)</li> <li>12. Analizat e dheut- (15)</li> <li>13. Trajtimi I thundrave tek gjedhi -39</li> <li>14. Analizat e dheut- (16)</li> <li>15. Të rinjët në Agrobiznes -37</li> <li>16. Përdorim i Makinave Bujqësore-freza, spërkatëse dhe shpërndarëse të plehut mineral - 90</li> </ol>
<p>Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ- ët</p>	<p>Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria e BZHRP-së ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore lidhur me organizimin e trajnimeve në fushën e bujqësisë.</p> <p>Bashkëpunimi me MBPZHR-së ka qenë kryesisht në implementimin e projekteve të Ministrisë siç janë: Projekti i shërbimeve këshillimore, projektet për subvencionim të fermerëve për lopë qumështore, kafshë të imëta (dele, dhi), bletë, projektet për subvencionimin e mbjelljeve pranverore, vjeshtore, subvencionimin e kulturave perimore, pemëtare dhe në projekte për aplikim në grande. Të gjithë fermerëve të cilët kanë qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim në subvencionet dhe grandet që ka ofruar MBPZHR. Të gjitha aplikacionet e fermerëve për subvencione janë pranuar në zyrën e DBZHRP-së, të cilat të kompletuara janë dorëzuar në MBPZHR.</p> <p>Nga projektet e MBPZHR për subvencionim, në komunën tonë kanë aplikuar 415 fermerë. Shuma e mjeteve të paguara nga subvencionet deri tani është 254,197.00 €, ndërsa në projektet e grandeve ka përfituar një fermerë në vlerë të përgjithshme prej 25,143.30 €.</p>

<p>Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale përmes shtimit të masave të veprimit në teren</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rojet e pyllit dhe stafi i sektorit të pylltarisë, janë angazhuar për pengimin e dëmtimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegal të masës drusore.</li> <li>- Janë konfiskuar <b>42.92m<sup>3</sup></b> ose shprehur në (mh.) metër hapësinore <b>60.51(mh)</b> , prej kësaj mase drusore 40%, sipas marrëveshjes i takojnë Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SHIL) ndërsa pjesa prej 60% e masës drusore të konfiskuar do të ndahen shkollave që kanë mungesë të masës drusore.</li> <li>- Janë ngritur <b>233</b> fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje <b>216 dhe 17</b> për vepër penale.</li> </ul>
<p>Organizimi i takimeve me kryetarin e Komunës, Komandantin e Stacionit Policor, Kryetarin e Gjykatës, Prokurorinë si dhe takimeve të rregullta javore me stafin e sektorit të pylltarisë.</p>	<p>Për mbajtjen në kontroll e gjendjes së pyjeve, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta: Komunë, Polici, Gjykatë dhe roje të pyllit, kemi organizuar takime të përbashkëta, me qëllim të ndikimit në pengimin e prerjeve ilegale të pyjeve.</p>
<p>Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore të dhëna me tender. Rrallimi në rajonin e Biçecit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi planit të paraparë për vitin 2018, shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menaxhimit, zgjedhja e operatorit ekonomik i cili i ka plotësuar kushtet sipas procedurave të prokurimit. Nga shitja e masës drusore me tender janë realizuar mjete në shumë prej <b>29,697.70 €</b></li> <li>- Janë kryer rrallime në Njësinë Menaxhuese “ Uji i Bardhë”, në sipërfaqe prej 10 ha, në vendin e quajtur “Lugu i Rubit”</li> </ul>
<p>Regjistrimi i terreneve nga prerjet ilegale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrimi i dëmeve në terren sipas rajoneve, duke përjashtuar pjesën e Parkut Kombëtar “Sharri”, që është kompetencë e MMPH</li> </ul>
<p>Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë pranuar <b>151</b> kërkesa për prerje në pyjet private ndërsa 151 prej tyre janë aprovuar, Nga kërkesat e aprovuara janë vulosur <b>4972.50 m<sup>3</sup></b> masë drusore për djegie për vitin 2018 të lejuar për prerje nga APK-ës. Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private janë realizuar <b>10462.76€</b>, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.</li> </ul>

Kryetari i Komunës së Kaçanikut  
Besim Ilazi

